29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumën përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

Neni 30 Shkaqet për kompensim

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFECTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose te riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, **një certifikatë e pranimit të përkohshëm.**

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit te Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë te punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës se defekteve dhe te cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës se defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do te filloj nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimit përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimit përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të pareaizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;

- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundoj vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 **"Force Madhore"** siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuhët në përdorim zyrtarë
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10 % e çmimit total të kontratës, nga një Bankë e licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës, apo kompani e sigurimeve e licensuar nga BQK deri me 10.10.2021
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve [shëno shumat]; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve [shëno shumat]; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën [shëno shumat]; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: [shëno shumat] (ii) të personave të tjerë: [shëno shumat]
Programi	12.1	Planin për Menaxhimin e Kontratës. Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda <u>2 ditëve</u> nga data e Nënshkrimit të kontratës
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 2 ditë nga data e pranimi të kërkesës së Menaxherit të projektit
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë : 2 (Dy) ditë pas nënshkrimit të kontratës, nëse kushtet atmosferike janë të përshtatshme (vlerësimi i Organit Mbikëqyrës të Autoritetit Kontraktues)
	17.2	Përfundimi i punëve bëhet sipas planit të menaxhimit të kontratës 10.09.2021

Dëmet e likuiduara	19.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.10% e Çmimit final të Kontratës në ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10% të çmimit final të kontratës
Regjistri i punës	20.1	<i>[Specifikoni nëse një regjistër i punës nuk është nevojitet].</i>
Inspektimi dhe testimi	22.1	Inspektimi i cilësisë dhe sasisë së punëve do të bëhet në momentin e dorëzimit që janë lëndë e kësaj kontrate, nga Komisioni I Pranimit të punëve – shërbimeve, i emëruar nga ana e Zyrtarit Kryesor Administrativ të Autoritetit Kontraktues. Asnjë furnizim i mallit respektivisht asnjë ekzekutim i punëve-shërbimeve nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet cilësia dhe sasia, nga ana e Komisionit të Pranimit të punëve-shërbimeve të Autoritetit Kontraktues. Menagjer i kontrates nga AK eshte: Bean Haxhiasi Menagjer i projektit nga AK eshte: Xhyllbehar Taipi Menagjer i projektit nga OE eshte: Arben Mazrekaj
Pagesat	24.1	Ky projekt eshte dy vjeqar: Pagesa do te behet: Viti-2020: 40 500,00 euro Viti-2021: 17 999,38 euro
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10 % e vleres se kontrates per periudhen një vjeqare
Shkaqet kompensim për	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë [shëno numrin] ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është : 12 muaj nga data e pranimit teknik të përkohshëm. Dokumenti Polisa e sigurimit të kualiteti e lëshuar nga një Bank apo kompani e sigurimeve e licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës 10 % vleren e

		pergjithëshme të kontratës, me afat validiteti për prej 12 muaj nga data e pranimi teknik të përkohshëm
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin në Kosovë. b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Prequllimi i rruges
Rruga - 11.6.11.11.11.11

RREGULLIMI I RRUGËS NË DY HYRJET E RRUGËVE NË FSHATIN BROD (PROJEKT DY VJEQAR)					
A ASFALTIMI I RRUGËS B=5.5 m ; L=322.50m					
Nr. rendor	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Cmimi njësi (€)	Cmimi total me TVSH (€)
Te gjitha punët në përputhje me normat teknike dhe standardet Europiane dhe Eurokodit , Kompania punë kryese është përgjegjëse për të marrë masat mbrojtëse dhe të siguroj punishten me mjetet sinjalizuese para fillimit të punët, nëgjithë zonën ku do të zhvilloj aktivitet e saj. Çdo dëmtim të instalimeve nëntokësore teqytetarëve është e obliguar t'i kthejë në gjendje të mëparshme me kosto të vetën financiare					
1	PUNËT PARAPRAKTE				
1.1	Mobilizimi i ndërmarrjes për aktivitet, vendosja e shenjave për sigurim të komunikacionit për aktivitet të punës në rrugë, në bashkpunim me menaxherin e projektit. Te dhënat : L=322.50 m' ; b=5.5 m' ; Trotuarë 1.30 m , kanal për ujërat atmosferik 1m në të dy anët ku ka lëshesa. Llog m'	m	322.50	0.01 €	3.23 €
1.2	Punëmarrësi është i detyruar që para fillimit të punimeve të bëjë rrethimin e punishtes, ti montoj barakat montazhe (kontejner) për punëtorët dhe për organin mbikqyrës. Pas përfundimit të punimeve të njëjtat duhet të largohen dhe të bëhet pastrimi i objektit dhe terrenit rreth objektit në tërësi.	komplet	1.00	0.92 €	0.92 €
1.3	Shenimi i trasës, si dhe percjellja e punimeve gjeodezike gjatë ekzekutimit duke i trajnuar edhe elemente përcjellëse të rrugës si : Kyqja e rrugëve dytësore , interseptimi (kryqëzimi) në bazë të projektit zbatues, në matjet gjeodezike të përfshihen të gjitha punët e përmendura në kushtet e përgjithshme dhe teknike, Llog në m1	m	322.50	0.30 €	96.75 €
				Gjithsej: Pos A1	100.90
2	PASTRIMI DHE DEMOLIMI TERENIT				
2.1	Pastrimi i terrenit largimi i drunjëve, shkurret dhe rrethojave me tela xhembore dhe mbeturinat apo gjësendet tjera të ngurta që e pengojnë gjatë ekzekutimit të rrugës. Pastrimi i tyre bëhet normal me drejtimin e rrugës me gjerësi të përcaktuar me projekt sipas profilin tërthorë si dhe largimin e tyre në deponim në të afërt. Në këtë pozicion përfshihet edhe demolimi i rrethojave dhe kthimin në gjendje të mëparshme pas përfundimit të punimeve. Llog .në m².	m'	322.50	0.50 €	161.25 €
2.4	Pastrimi, zhblokimi dhe mirëmbajtja e lëshesave ekzistuese për ujëra atmosferik në aksin e rrugës në të dy anët e rrugës.	m'	322.50	0.50 €	161.25 €
2.5	Demontimi , dhe zhvendosja e kubëzave në rrugën egzistuese e cila do të rehabilitohet , si dhe deponimi i përkoshëm në njëvend të sigurt të përcaktuar nga organi mbikqyrës duke i mbrojtur pa i dëmtuar gjatë demontimit dhe transportit me qëllim të ripërdorimit të tyre në rrugë të planifikuara sekondare . Në çmim kalkulohet edhe transporti prej vendit demontimit deri në vendin e magazinimit (Deponimit).	m2	1800	0.35 €	630.00 €
2.6	Demontimi , dhe zhvendosja e skajorëve në rrugën egzistuese e cila do të rehabilitohet , si dhe deponimi i përkoshëm në njëvend të sigurt të përcaktuar nga organi mbikqyrës duke i mbrojtur pa i dëmtuar gjatë demontimit dhe transportit me qëllim të ripërdorimit të tyre në rrugë të planifikuara sekondare . Në çmim kalkulohet edhe transporti prej vendit demontimit deri në vendin e magazinimit (Deponimit).	m3	612	0.50 €	306.00 €
				Gjithsej: Pos A 2	1,258.50
3	PUNIMET TOKËSORE				
Gërryerja , gërmimi dhe largimi i dheut të kat III -V Me makina ndërtimore në vendet e projektuara për nivelizimin dhe zgjerimin dhe rregullimin e rrugës lokale me trashësi t = 20 deri në 40 cm . Në këtë pozicion përfshihet edhe nivelizimi terrenit me ramjet e duhura duke përfshirë edhe elementet tjera përcjellëse të përcaktuar në projekt sipas kushteve teknike dhe përgjithshme , si dhe detaleve teknike . Largimi i dheut të gërryuar në deponim të cilën e cakton investitori Llog m3 me të gjitha shpenzimet.					
3.1	Gërmimi me makineri (70%)	m3	740.39	1.00 €	740.39 €
3.2	Gërmimi me dorë (20%)	m3	211.54	1.00 €	211.54 €
3.3	Gërmimi me çekan (10%)	m3	105.77	1.00 €	105.77 €
Punimi i planimit dhe bankinave të rrugës dhe trotuarve me bartje të materialit shtrirje , rrafshim dhe ngjeshje me cilindër vibrues 18 tonë sipas kushteve përgjithshme dhe teknike të specifikuar në projekt.					
3.4	Punimi i planimit dhe bankinave	m3	233.81	1.00 €	233.81 €
				Gjithsej: Pos A 3	1,291.51
4	PUNIMET E MBUSHJES (TAMPONI)				
Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i shtresës stabilizuese me material mbushës nga guri gëlqeror që i plotëson kushtet dhe kriteret e parapara për tampon Fraksion 0-150 mm për stabilizim të pjesëve anësore dhe plotësim të trasës së rrugës. Ngjeshet në shtresë me trashësi t=30 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=250 kg/cm2 . Sqarim : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompani punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin moduli të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.					

4.1	Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-150 mm, shtrirja dhe ngjeshja në shtresa çdo t=30cm deri në lartën e mbushjes të përcaktuar në projekt	m3	1920.00	2.00 €	3,840.00 €
Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i shtresës së rrugëve me zhavorr nga gurit të thyer fraksion 0-63 mm, me trashësi të shtresës t=20 cm të cila i plotëson kushtet e parapara për tampon si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=600 kg/cm2. Sqarim: Pas përfundimit të kësaj shtrese kompani punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin moduli të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.					
4.2	Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-63 mm ; t=30 cm	m3	701.44	3.00 €	2,104.32 €
Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i shtresës së rrugëve me zhavorr nga gurit të thyer fraksion 0-31.5mm, me trashësi të shtresës t=10 cm, të cila i plotëson kushtet e parapara për tampon si dhe nivelizimi dhe ngjeshja për materialin e bankinave në të dy anet e rrugës në gjerësi (1 x 0.75 cm) dhe ramje 4% ngjeshja bëhet me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=800 kg/cm2. Sqarim: Pas përfundimit të kësaj shtrese kompani punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin moduli të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.					
4.3	Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-31.5 mm ; t= 10 cm	m3	217.71	4.00 €	870.84 €
5	PUNIMET E LËSHESAVE (TOMBINAVE) DHE KANALEVE TË HAPURA	Gjithsej: Pos A4			6,815.15
Punimi i lëshesave, pjesëve kaluese dhe kanaleve të mbyllura në disa pjesë të rrugës sipas detajeve të dhëna në projekt. Në çmim është llogaritur hapja e kanalit dhe vendosja e rrës, furnizimi dhe vendosja e gypit armuar, duke duke përfshirë edhe koken hyrëse dhe dalje të lëshesës nga beton armje sipas detajit teknik të prezantuar në projekt llog në m' me të gjitha shpenzimet					
5.1	Lëshes Ø 600mm deri 10 m gjatësi	m'	40.00	15.00 €	600.00 €
6	PUNIMET E MBISTRUKTURËS ASFALTIT DHE BETONIT	Gjithsej: Pos A5			600.00
6.1	Furnizimi, transporti dhe punimi i asfalt betonit nga materiali i njëtrajtshëm BZH 22 me trashësi t=8,0cm, në qumim përfshihet edhe zgjerimi nëpër kthesa Vërejtje: Të mirren mostrat në vend dhe të bëhet ATESTI-METODA MARSHALL	m2	1773.75	10.00 €	17,737.50 €
Gjithsej: Pos A6					17,737.50

REKAPITULIMI I ASFALTIMIT E RRUGËS

1	PUNËT PARAPRAKE	100.90 €
2	PASTRIMI DHE DEMOLIMI TERENIT	1,258.50 €
3	PUNIMET TOKËSORE	1,291.51 €
4	PUNIMET E MBUSHJES (TAMPONIT)	6,815.15 €
5	PUNIMET E LËSHESAVE (TOMBINAVE) DHE KANALEVE TË HAPURA	600.00 €
6	PUNIMET E MBISTRUKTURËS ASFALTIT DHE BETONIT	17,737.50 €
TOTALI ME TVSH		27,803.56 €

B. NDËRTIMI I TROTUARVE B=1.30m ; L=322.50 m					
Nr. rendor	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Cmimi njësi (€)	Cmimi total me TVSH (€)
1.0	PUNËT PARAPRAKE				
1.1	Mobilizimi dhe rregullimi i punishteve për punë si dhe largimi i instalimeve në punishte në rast se ka në ato hapësira.	m'	322.50	0.01	3.23 €
1.2	Shenimi i trasesë si dhe percjellja e punimeve gjeodezike gjatë ekzekutimit.	m'	322.50	0.10	32.25 €
1.3	Pastrimi i trasesë së rrugës nga të gjitha materialet që pengojnë përgatitjen e plenumit. Në qumim të kalkulohen të gjitha materialet e panevojshme kompleti për gjatësi të rrugëve.	m'	322.50	0.50	161.25 €
Gjithsej B1.0:					196.73 €
2.0	PUNIMET E DHEUT				
2.1	Gërmimi i tamponit t=10 cm me mundësi që i njëjti prap të perdoret.	m³	54.99	5.00	274.93 €
2.2	Gërmimi i dheut me makineri i kategorisë së IV-V të me ngarkim dhe bartje deri në depoti (deri në 15Km). Sasia të llogaritet në gjendje natyrale.	m³	299.93	2.00	599.85 €
2.3	Formësimi dhe ngjeshja e nënbazës së trupit të rrugës me ngjeshmëri 40MN/m2.	m³	499.88	0.50	249.94 €
Gjithsej B2.0:					1,124.72 €
3.0	MBISTRUKTURA				
3.1	Furnizimi, transporti dhe punimi i tamponit (80MN/m²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-63mm me trashësi t=25cm, si dhe ngjeshja me cilindër 25t.	m³	124.97	3.00	374.91 €

3.2	Furnizimi, transporti dhe punimi i tamponit (100MN/m ²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-31.5mm me trashësi t=15cm, si dhe ngjeshja me cilindër 25t.	m ³	62.89	4.00	251.55 €
3.3	Furnizimi, transporti dhe vendosja e skajoreve në bazament betoni, C-35/37. me dim. 15x22x100cm me dim. 10x22x100cm	m' m'	322.50 322.50	5.00 4.00	1,612.50 € 1,290.00 €
3.4	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e kubzave të betoni t=8cm, C-35/37 në shtresë rëre frak. (4-8)mm me t=5cm dhe mbushja e fugave me rër, duke përfshir edhe zgjerimet dhe kyojet në rrugë.	m ²	461.18	9.00	4,150.58 €
3.5	Rregullimi i trases dhe pastrimi i punishtës nga materialet ndërtimore.	m'	322.50	0.10	32.25 €
Gjithsejt B3.0:					7,711.78 €

251,56

✓

4 150,62

✓

7 711,84

D		REKAPITULIMI I TROTUARVE	
1.0	PUNËT PARAPRAKE	Gjithsej 1.0:	196.73 €
2.0	PUNIMET E DHEUT	Gjithsej 2.0:	1,124.72 €
3.0	MBISTRUKTURA	Gjithsejt 3.0:	7,711.78 €
		TOTALI ME TVSH:	9,033.23 €

7 124,95

7 711,84

9 033,32

NDËRTIMI I KANALIT TË HAPËR ATMOSFERIK NGA BETONI L=60m					
Nr. rëndor	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
1.0	PUNËT TOKËSORE DHE ZHAVORRIKE				
1.1.1	Gërmimi me dorë, makina, dhe Çekan dhe transporti deri në depoti i dheut, me ngarkim dhe shkarkim në vendin ku e cakton organi mbikqyrës, dheu është i kateg. së III-të IV, V dhe VI-të. Tëhet e kanaleve duhet të gërmohen në formë të rregullt dhe të përpunohet fundi i kanalit. Dheu i mihur duhet të menjahet larg kanalit në largësi min. 1,00 m'. - Gërmimi me makina në thellësinë mesatare të kanalit deri në Th= 0.6m', dhe gjerësi b=0.80m, në çmim duhet llogaritur edhe mbrojtja e kanalit nga shembja				
	gërmimi me makinë 60%	m ³	17.28	2.00 €	34.56 €
	gërmimi me dorë 20%	m ³	5.76	2.00 €	11.52 €
	gërmimi me Çekan 10%	m ³	2.88	2.00 €	5.76 €
1.1.2	Mbrojtja e gropës kanalit në tërë gjatësinë e kanalit.	m'	60	0.50 €	30.00 €
1.1.4	Planifikimi i fundit të kanalit pas përfundimit të gërmimit duke dhënë ramjen e saktë sipas projektit. Llogaritja bëhet për 1 m2 të sipërfaqes reale të planifikuar.	m ²	48.00	1.00 €	48.00 €
1.1.5	Furnizimi, shtrirja, transporti dhe vendosja e shtresës së rërës dhe zhavorit d=5cm, para se të betonohet bazamenti i kanalit atmosferik sipas detajit në projekt.	m ³	2.40	10.00 €	24.00 €
1.1.7	Mbushja dhe nivelimi i material nga guri gëlqeror tampon 0-60mm në pjesët anësore në të dyja anët e mureve të elementeve të parafabrikuar të betonit duke e ngjeshur në shtresë max 20-30 cm me Mv>90Mn/m2. Me qëllim të stabilizimit të kanalit atmosferik, pas qitjes së zhavorrit mbulohet me një pjesë të dheut të gërmuar e cila ngjeshet për të parandaluar shpërlarjen e zhavorrit anësorë, ndërsa dheu i tepër ngarkohet dhe largohet me transport deri në depotin e afër. Llog për m3	m ³	36.00	4.00 €	144.00 €
1.1.9	Largimi i ujit nga kanali nëse paraqitet gjatë gropimit të kanalit.	ore	5	5.00 €	25.00 €
Gjithsejt: Pos C1				322.94	

✓

✓

✓

✓

✓

✓

✓

Nr. 2	PUNËT ME ELEMENTE PARAFABRIKUAR NGA BETONIT PËR NDËRTIMIN E KANALIT AMTOFERIK TË HAPURË	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithësej (€)
2.1.1	Furnizimi, transporti, dhe punimi kanalit atmosferik nga me kallup form " V " sipas detalit dhe planit armaturë, betonimi me Beton Arme të klasës C -30/37 me armaturë konstruktive S400/500 për bazamentin dhe muret e kanalit me pregaditje të kallëpeve nga drasat si dhe betonimi i tyre, betoni duhet vibruar dhe situar aditive për papërshkrushmeri të ujit dhe qendrueshmëri ndaj ngjicave, me ramje gjatësore konform konfiguracionit të terrenit duke i përcjellë kuotat dhe nivelin e rrugës me ramjet tërthore dhe gjatësore. Punimet të kryhen sipas standardeve, normativave ndërtimore dhe detaleve grafike dhe arminut të paraqitur në projekt .Llog. për m' Vërejtje kompania punëkryese para se ta hudson në vepër betonit duhet ti prezentoj atestet e betonit dhe aditiveve	m³	60.00	65.00 €	3,900.00 €
Gjithësej: Pos C 2					3,900.00
C REKAPITULIMI I KANALIT ATMOSFERIK					
1.0	PUNËT PARAPRAKE	Gjithësej C 1.0:		322.84 €	
2.0	PUNIMET E DHEUT	Gjithësej C 2.0:		3,900.00 €	
TOTALI ME TVSH:					4,222.84 €
D PUNËT E DRENAGEIMIT					
Nr. rendor	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
